REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 28 maj 2026
Nr. ref.: AGJ3098/26

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI116/24

Parashtrues

P. K.

Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktvendimit [Pml. nr. 477/2023] të 29 nëntorit 2023 të Gjykatës Supreme

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga P. K., i përfaqësuar nga Ylli Bokshi avokat nga Gjakova (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [Pml. nr. 477/2023] e 29 nëntorit 2023 të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [PAKR. nr. 225/23] e 10 majit 2023 të Gjykatës së Apelit (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [PKR. nr. 132/22] të 15 marsit 2023 të Gjykatës Themelore në Pejë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] 32 [E Drejta për Mjete Juridike] 34 [E Drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata moszbulimin e identitetit të tij.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 (Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara) të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 15 maj 2024, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij përmes postës të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) e pranoi më 2 maj 2024.

7. Më 22 maj 2024, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr. GJR. KI116/24], caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Vendimin [nr. KSH. KI116/24], caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).

8. Më 29 maj 2024, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 29 maj 2024, Gjykata njoftoi dhe kërkoi nga Gjykata Themelore që të dorëzojë fletëkthesën përmes së cilës vërtetohet se kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar Aktvendimi i kontestuar [Pml. nr. 477/2023] i 29 nëntorit 2023 i Gjykatës Supreme.

10. Më 10 dhjetor 2024, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës, rregullit 8 (Zgjedhja e Kryetarit/es dhe e Zëvendëskryetarit/es) të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-1/24], të 10 dhjetorit 2024, gjyqtari Nexhmi Rexhepi u zgjodh Kryetar i Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 të Rregullores së punës dhe vendimit të lartcekur të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtari Nexhmi Rexhepi, detyrën e Kryetarit të Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, më 30

dhjetor 2024. Të njëjtën ditë, përkatësisht më 10 dhjetor 2024, përmes Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-2/24] gjyqtari Safet Hoxha u zgjodh Zëvendëskryetar i Gjykatës, dhe bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 (Zgjedhja e Kryetarit/es dhe e Zëvendëskryetarit/es) të Rregullores së punës dhe vendimit të lartcekur të Gjykatës u përcaktua që gjyqtari Safet Hoxha, detyrën e Zëvendëskryetarit e merr më 11 dhjetor 2024.

11. Më 30 dhjetor 2024, bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 të Rregullores së punës dhe Vendimit [KK-SP 812-1/24] të 10 dhjetorit 2024 të Gjykatës, gjyqtari Nexhmi Rexhepi mori detyrën e Kryetarit të Gjykatës, ndërsa bazuar në nënparagrafin 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, kryetarja Gresa Caka-Nimani përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

12. Në të njëjtën ditë, bazuar në nënparagrafin 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 të Ligjit, edhe gjyqtarja Selvete Gërxhaliu-Krasniqi përfundoi mandatin e gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

13. Më 8 janar 2025, Kryetari Gjykatës Nexhmi Rexhepi, përmes Vendimit KSH. KI116/24 caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi anëtar në Kolegjin shqyrtues në vend të Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, mandati i së cilës si gjyqtare kishte përfunduar më 30 dhjetor 2024. Bazuar në pikën I të vendimit të lartcekur, Kolegji shqyrtues, ka këtë përbërje: Safet Hoxha (kryesues), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).

14. Më 5 nëntor 2025, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe vendosi që rasti të shtyhet për shqyrtim në një nga seancat e radhës.

15. Më 7 nëntor 2025, Gjykata i dërgoi një shkresë Gjykatës së Apelit dhe kërkoi nga ajo informatat si në vijim: (i) të informojë Gjykatën lidhur me statusin aktual të lëndës që ka të bëjë me rastin e parashtruesit të kërkesës, i cili është rikthyer për rivendosje në Gjykatën e Apelit, në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Supreme [Pml. nr. 504/2023] të 29 nëntorit 2023; (ii) Nëse për këtë rast tashmë është marrë një vendim nga Gjykata e Apelit, ju lutemi ta dorëzoni kopjen e atij vendimi në Gjykatë.

16. Më 13 nëntor 2025, Gjykata e Apelit njoftoi Gjykatën se rasti mban numrin PAKR. nr. 310/2024 dhe është i caktuar tek gjyqtari, por ende nuk është vendosur lidhur me të.

17. Më 28 janar 2026, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe vendosi që rasti të shtyhet për shqyrtim në një nga seancat e radhës.

18. Më 3 shkurt 2026, Gjykata i dërgoi sërish një shkresë Gjykatës së Apelit dhe kërkoi nga ajo informatat si në vijim: (i) të informojë Gjykatën lidhur me statusin aktual të lëndës që ka të bëjë me rastin e parashtruesit të kërkesës, i cili është rikthyer për rivendosje në Gjykatën e Apelit, në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Supreme [Pml. nr. 504/2023] të 29 nëntorit 2023; (ii) Nëse për këtë rast tashmë është marrë një vendim nga Gjykata e Apelit, ju lutemi ta dorëzoni kopjen e atij vendimi në Gjykatë.

19. Më 10 shkurt 2026, Gjykata e Apelit njoftoi Gjykatën se ende nuk është vendosur lidhur me rastin në fjalë.

20. Më 2 prill 2026, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata me gjashtë (6) vota "*për*" dhe një (1) votë "*kundër*", vendosi: (i) ta deklarojë kërkesën e pranueshme; (ii) të konstatojë se Aktvendimi [Pml. nr. 477/2023] i 29 nëntorit 2023 i Gjykatës Supreme të Kosovës nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, si dhe

paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin [Pml. nr. 477/2023] e 29 nëntorit 2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës; (iv) të kthejë Aktvendimin [Pml. nr. 477/2023] e 29 nëntorit 2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës në rivendosje, sipas konstatimeve të këtij Aktgjykimi.

Përmbledhja e fakteve

i) <u>Procedurat në lidhje me veprën penale</u>

21. Më 26 mars 2012, Prokuroria e Qarkut në Pejë ka ngritur aktakuzën [PP. nr. 68/12] ndaj parashtruesit të kërkesës dhe F. H. dhe A. I., për veprën penale të dhunimit nga neni 193, paragrafi 3 pika 5 lidhur me paragrafin 4, lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës të vitit 2004, i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale (në tekstin e mëtejmë: KPRK).

22. Më 6 nëntor 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë përmes Aktgjykimit [P. nr. 241/12] shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale të dhunimit nga neni 193, paragrafi 3 pika 5 lidhur me paragrafin 4 të KPRK-së dhe e dënoi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, në të cilin dënim iu është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga 29 shkurti 2012 deri më 6 nëntor 2012.

23. Më 5 prill 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit [P. nr. 241/12] të Gjykatës së Qarkut në Pejë.

24. Më 13 mars 2014, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PAKR. nr. 222/2013] aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vendosi ta anulojë Aktgjykimin [P. nr. 241/12] e 6 nëntorit 2012 të Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe lëndën e ktheu në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

25. Më 27 mars 2014, Gjykata Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore në Pejë), përmes Aktvendimit [P. nr. 87/2014] ishte shpallur jokompetente në pikëpamje territoriale për të vendosur në çështjen e parashtruesit të kërkesës.

26. Më 11 qershor 2014, Gjykata Themelore në Gjakovë-Departamenti për të Mitur (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore në Gjakovë) i është drejtuar Gjykatës së Apelit me Kërkesën [PKR. nr/81/2014] që të zgjidhet konflikti i kompetencave në mes këtyre dy gjykatave, përkatësisht Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe asaj në Pejë.

27. Më 1 korrik 2014, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN. nr. 331/2014] aprovoi kërkesën e Gjykatës Themelore në Gjakovë, dhe ndryshoi Aktvendimin [P. nr. 87/2014] e 27 marsit 2014 të Gjykatës Themelore në Pejë, ashtu që në çështjen penale ndaj parashtruesit të kërkesës dhe dy të tjerëve F. H. dhe A. I., për shkak të veprës penale dhunimi nga neni 193, paragrafi 3 pika 5 lidhur me paragrafin 4, lidhur me nenin 23 të KPK-së, e shpalli kompetente në pikëpamje territoriale Gjykatën Themelore në Pejë.

28. Më 18 maj 2015, Gjykata Themelore në Pejë – Departamenti për të Mitur në seancën e shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues ka marrë aktvendim me të cilin është veçuar procedura penale kundër parashtruesit të kërkesës nga procedura penale ndaj të miturve F.H. dhe A.I., ku lënda penale ndaj parashtruesit të kërkesës ka marrë numrin e ri [PKR. nr. 141/15].

29. Më 12 korrik 2021, Gjykata Themelore në Pejë përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 141/2015] shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe e dënoi me dënim me burgim në kohëzgjatje

prej tetë (8) muaj e tetë (8) ditë, duke ia llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga 29 shkurti 2012 deri më 6 nëntor 2012.

30. Më 30 mars 2021, e dëmtuara L. N. ka ushtruar ankesë kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 141/2015] të 12 korrikut 2021 të Gjykatës Themelore në Pejë.

31. Më 6 korrik 2022, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PAKR. nr. 217/2022] e anuloi Aktgjykimin [PKR. nr. 141/2015] e 12 korrikut 2021 dhe çështjen e ktheu në rigjykim dhe rivendosje.

32. Më 16 shkurt 2023, Gjykata Themelore në Pejë në rigjykim, përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 132/22] shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për shkak të kryerjes së veprës penale të dhunimit nga neni 193, paragrafi 3 pika 5 lidhur me paragrafin 4 dhe nenin 23 të KPK-së, dhe e gjykoi: (i) me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) vite e gjashtë (6) muaj, ku në dënimin e shqiptuar i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 29 shkurtit 2012 deri më 6 nëntor 2012; (ii) e dëmtuara L. N. për realizimin e kërkesës pasurore juridike u udhëzua në kontest të rregullt juridiko-civil; (iii) parashtruesit të kërkesës pas shpalljes së aktgjykimit sipas nenit 367, paragrafi 1 pika 1.1 e paragrafit 2 lidhur me nenin 187, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 pika 1.2.1 dhe 1.2.3 të KPPRK-së, i është caktuar masa e paraburgimit me aktvendim të veçantë të 16 shkurtit 2023, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar.

33. Në një datë të pasaktësuar, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, vendimit lidhur me sanksionin penal dhe vendimit lidhur me shpenzimet e procedurës penale, duke i propozuar Gjykatës së Apelit që ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe në kuptim të nenit 363, paragrafi 1, pika 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, të marrë aktgjykim me të cilin parashtruesi i kërkesës lirohet nga akuza, apo që aktgjykimin e atakuar ta anulojë dhe çështjen t'ia kthejë Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

34. Kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 132/22] të 16 shkurtit 2023 të Gjykatës Themelore, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë te Prokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për të Mitur, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që kolegji për të mitur i Gjykatës së Apelit ankesën ta aprovojë si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë dhe të akuzuarit t'i shqiptojë një dënim më të lartë në pajtim me ligjin, ose çështjen ta kthejë në rivendosje.

35. Më 10 maj 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 225/23] (i) aprovoi si të bazuar ankesën e mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës, dhe sipas detyrës zyrtare, ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për të Mitur [PKR. nr. 132/2022], përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale dhe vendimit mbi dënimin, duke arsyetuar se me veprimet e parashtruesit të kërkesës formësohen elementet e figurës së veprës penale dhunimi nga neni 193, paragrafi 4 lidhur me nenin 23 të KPK-së, dhe i shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vitesh, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga 22 shkurti 2012 deri më 6 nëntor 2012; (ii) refuzoi ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti për të Mitur, përkitazi me sanksionin penal, si të pabazuar; (iii) në pjesët tjera aktgjykimi mbeti i pandryshuar.

ii) procedurat në lidhje me kërkesën për rishikim të procedurës penale

36. Në një datë të pasaktësuar, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës paraqiti kërkesë për rishikim të procedurës penale "*duke pretenduar provë të re*".

37. Më 19 korrik 2023, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PK. nr. 110/2023] refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishikim të procedurës penale.

38. Në një datë të pasaktësuar, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit [PK. nr. 110/2023] të 19 korrikut 2023 të Gjykatës Themelore.

39. Më 29 gusht 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN. nr. 1001/2023] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa e vërtetoi aktvendimin e Gjykatës Themelore [PK. nr. 110/2023].

iii) procedurat në lidhje me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë

40. Në një datë të pasaktësuar, kundër Aktvendimit [PK. nr. 110/2023] të 19 korrikut 2023 të Gjykatës Themelore dhe Aktvendimit [PN. nr.1001/2023] të 29 gushtit 2023 të Gjykatës së Apelit, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, me propozimin që Gjykata Supreme ta aprovojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të bazuar dhe të anulohen aktvendimet e kontestuara dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë ose të ndryshohen ashtu që të aprovohet kërkesa për rishikim të procedurës penale.

41. Në një datë të pasaktësuar, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës po ashtu paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [PAKR. nr. 225/23] të 10 majit 2023 të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore, me propozimin që t'i anulojë aktgjykimet e Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 225/2023] të 10 majit 2023 dhe të Gjykatës Themelore [PKR. nr. 132/2023] të 15 marsit 2023 dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

42. Më 29 nëntor 2023, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 504/2023] aprovoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës dhe anuloi aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë [PK. nr. 110/2023] të 19 korrikut 2023 dhe atë të Gjykatës së Apelit [PN. nr. 1001/2023] të 29 gushtit 2023, dhe çështjen ia ktheu Gjykatës së Apelit që të vendosë lidhur me kërkesën për rishikim të procedurës penale si gjykatë kompetente.

43. Më 29 nëntor 2023, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Pml. nr. 477/2023] hodhi si jolëndore kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 132/2022] i 15 marsit 2023 të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit [PAKR. nr. 225/23] të 10 majit 2023 të Gjykatës së Apelit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

44. Parashtruesi i kërkesës thekson që Aktvendimi [Pml. nr. 477/2023] i 29 nëntorit 2023 i Gjykatës Supreme, është marrë në kundërshtim me të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese, përkatësisht nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 34 [E Drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

45. Parashtruesi i kërkesës pretendon se atij i është "*mohuar e drejta në mjet juridik kur i është hedhur kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë si jolëndore",* pasi që sipas

parashtruesit kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në lidhje me procedurat për rishikim të procedurës penale dhe procedurat sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë për çështje kryesore janë të ndara. Sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme është dashur të ndërpresë procedurën sipas kërkesës së mbrojtjes së ligjshmërisë për çështje kryesore deri sa të vendoset meritorisht në kërkesën për rishikim të procedurës. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson: "*vlen të theksohet se procedura e rishikimit të procedurës penale në bazë të një prove të re është ende aktive, vendimet e atakuara me këtë kërkesë me shumë gjasë mund të anulohen si res judicata, por që shkeljet kushtetuese nga sistemi i drejtësisë në këtë çështje kanë ndodhur*".

46. Parashtruesi thekson që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në lidhje me kërkesën për rishikim të procedurës "*e cila është trajtuar në të njëjtën kohë/paralelisht me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë me çështjen kryesore kundër aktgjykimit. Sipas vlerësimit të mbrojtjes këto çështje janë të ndara dhe të njëjtat ashtu ka qenë dashur nga Gjykata Supreme të trajtohen"*. Prandaj, sipas parashtruesit të kërkesës me aktvendimin e kontestuar atij i janë shkelur të drejtat e garantuara *"me kushtet për mjet juridik nenit 32 dhe nenit 102, par.5 të Kushtetutës..."*.

47. Tutje, parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk i është lejuar të paraqesë provat para Gjykatës, përkatësisht duke mos iu lejuar ekspertiza atij i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk ka mundur të paraqesë provën që do të dëshmonte që është gjykuar dy herë ashtu që atij i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 34 të Kushtetutës.

48. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës pretendon se aktakuza është ngritur në vitin 2012 dhe se gjykimi nuk është përfunduar në afat të arsyeshëm. Tutje, parashtruesi i kërkesës thekson që " *pa fajin e parashtruesit të kërkesës ka zgjatur mbi 10 vite dhe të njëjtit i është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim në afat të arsyeshëm e garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës*". Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës i referohet Aktgjykimit KI64/23.

49. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon që: (i) të deklarojë kërkesën e pranueshme; (ii) të konstatojë se aktvendimi i Gjykatës Supreme, aktgjykimi i Gjykatës së Apelit dhe ai i Gjykatës Themelore nuk janë në përputhshmëri me nenin 31, 32, 34 dhe 102 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; (iii) të shpallë të pavlefshëm aktvendimin e Gjykatës Supreme, aktvendimin e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore; (iv) ta rikthejë çështjen në rigjykim dhe rivendosje.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës
Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]

4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
[...]"

Neni 32
[E Drejta për Mjete Juridike]

"Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj".

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për gjykim të drejtë)

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte
interesat e drejtësisë.
[...]."

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

50. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa e parashtruesit të kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

51. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

[...]

52. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

53. Gjykata fillimisht vëren që parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar e cila konteston aktin e autoritetit publik, përkatësisht Aktvendimin [Pml. nr. 477/2023] e 29 nëntorit 2023 të Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur përmes aktit të kontestuar, në pajtim me kriteret e nenit 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit, ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 (Afatet) të Ligjit.

54. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 34 të Rregullores së punës. Për më tepër dhe në fund, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar siç është e përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës dhe, rrjedhimisht, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

55. Gjykata rikujton se ndaj parashtruesit të kërkesës ishte ngritur aktakuzë nga Prokuroria e Qarkut në Pejë për veprën penale të dhunimit sipas nenit 193, paragrafi 3 pika 5 lidhur me paragrafin 4 dhe nenin 23 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të vitit 2004. Me Aktgjykimin [P. nr. 241/12] të 6 nëntorit 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë e shpalli fajtor dhe e dënoi me 2 (dy) vite burgim, duke i llogaritur kohën e kaluar në paraburgim nga 29 shkurti 2012 deri më 6 nëntor 2012. Pas ankesës së parashtruesit, Gjykata e Apelit me Aktvendimin [PAKR. nr. 222/2013] e anuloi aktgjykimin dhe e ktheu çështjen në rigjykim. Pas zgjidhjes së konfliktit të kompetencës ndërmjet Gjykatës Themelore në Pejë dhe asaj në Gjakovë, çështja u rigjykua disa herë. Me Aktgjykimin [PKR. nr. 141/2015] të 12 korrikut 2021, Gjykata Themelore në Pejë e dënoi parashtruesin me 8 (tetë) muaj e 8 (tetë) ditë burgim, por ky aktgjykim u anulua nga Gjykata e Apelit me Aktvendimin [PAKR. nr. 217/2022] dhe çështja u kthye serish në rigjykim. Në rigjykim, me Aktgjykimin [PKR. nr. 132/22] të 16 shkurtit 2023, Gjykata Themelore në Pejë e dënoi parashtruesin me 5 (pesë) vite e 6 (gjashtë) muaj burgim dhe i caktoi paraburgim pas shpalljes së aktgjykimit. Pas ankesave të mbrojtjes dhe të prokurorisë, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin [PAKR. nr. 225/23] të 10 majit 2023 ndryshoi cilësimin juridik të veprës penale dhe e dënoi parashtruesin me 2 (dy) vite burgim, duke refuzuar ankesën e prokurorisë. Ndërkohë, parashtruesi paraqiti kërkesë për rishikim të procedurës penale, e cila u refuzua nga

Gjykata Themelore me Aktvendimin [PK. nr. 110/2023] dhe u vërtetua nga Gjykata e Apelit me Aktvendimin [PN. nr. 1001/2023]. Kundër këtyre vendimeve dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Me Aktgjykimin [Pml. nr. 504/2023] të 29 nëntorit 2023, Gjykata Supreme aprovoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë lidhur me rishikimin dhe anuloi vendimet e gjykatave më të ulëta, duke e kthyer çështjen në Gjykatën e Apelit për vendimmarrje si gjykatë kompetente. Ndërsa, me Aktvendimin [Pml. nr. 477/2023] të po asaj date, Gjykata Supreme hodhi si jolëndore kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimeve lidhur me fajësinë dhe dënimin.

56. Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ndërlidhet me mohimin e të drejtës së tij për "*qasje në gjykatë*" dhe të drejtës për mjete juridike si pasojë e hedhjes poshtë të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga ai në Gjykatën Supreme. Si pasojë, ai pretendon se i janë mohuar të drejtat e garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës; si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

57. Prandaj, Gjykata do të trajtojë pretendimet e parashtruesit në kuadër të së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së dhe të drejtës për mjete juridike të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës. Gjykata do t'i shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke aplikuar parimet përkatëse të përcaktuara nëpërmjet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në bazë të të cilave, Gjykata, në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e obliguar që: *"Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut"*.

(a) Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për "qasje në gjykatë" dhe të drejtën për mjete juridike

58. Përkitazi me të drejtën për "*qasje në gjykatë*", si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata thekson se, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të cilën e ka përvetësuar edhe Gjykata, rezulton ndër të tjera se: (i) e drejta në gjykatë përcakton që ndërgjyqësit duhet të kenë një mjet efektiv juridik që ua mundëson mbrojtjen e të drejtave të tyre civile; (ii) çdokush ka të drejtë që të paraqesë "*padi*" lidhur me të "*drejtat dhe detyrimet civile*" përkatëse te një gjykatë; (iii) duhet të ekzistojë një "*e drejtë civile*" dhe të ketë një "*kontest*" lidhur me ligjshmërinë e një ndërhyrjeje, kontest ky i cili duhet të jetë serioz dhe rezultatet e procedurave para gjykatave duhet të jenë "*vendimtare*" për të drejtën civile në fjalë; (iv) e drejta e qasjes në gjykatë duhet të jetë "*praktike dhe efektive*" dhe jo "*teorike dhe iluzore*"; (v) e drejta e qasjes në gjykatë nuk është absolute, por mund t'i nënshtrohet kufizimeve të cilat nuk mund të zvogëlojnë qasjen në gjykatë deri në një masë që cenojnë vetë thelbin e së drejtës, kufizime të cilat duhet të arsyetohen, të ndjekin një qëllim legjitim dhe të ketë proporcionalitet midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet; dhe (vi) vlerësimi nëse procedurat kanë qenë të drejta ose jo, vlerësohet duke pasur parasysh zhvillimin e tyre në tërësi (për një elaborim më të detajuar përkitazi me parimet e të drejtës për qasje në gjykatë, shih rastet e GJEDNJ-së: *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 4451/70, Aktgjykim i 21 shkurtit 1975; *Běleš dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, nr. 47273/99, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002; *Naït-Liman kundër Zvicrës,* nr. 51537/07, Aktgjykim i 15 marsit 2018; *Le Compte, Van Leuven and De Meyere kundër Belgjikës*, nr. 6878/75; 7238/75, Aktgjykim i 23 qershorit 1981, paragrafi 45; *Moreira de Azevedo kundër Portugalisë*, nr. 11296/84, Aktgjykim i 23 tetorit 1990, paragrafi 66; *Z. dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 29392/95, Aktgjykim i 10 majit 2001, paragrafi 92); *Famullia Katolike Greke e Lupenit kundër Rumanisë [DHM],* nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 84); si dhe rastet e Gjykatës: KI62/17, parashtruese *Emine Simnica,* Aktgjykim i 29 majit 2018; KI224/19, parashtrues

Islam Krasniqi, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020; KI20/21, parashtruese *Violeta Todorović* Aktgjykim i 13 prillit 2021; KI54/21, parashtrues *Kamber Hoxha,* Aktgjykim i 4 nëntorit 2021; KI49/23, parashtrues *Shaban Dulahu dhe të tjerët,* Aktgjykim i 11 shtatorit 2024, KI138/25, parashtrues "*Lirik Dragusha*" B.I, Aktgjykim i 21 tetorit 2025).

59. Prandaj, në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe GJEDNJ-së, e drejta e qasjes në gjykatë nuk nënkupton vetëm të drejtën për të filluar procedurat pranë një gjykate, por, me qëllim që e drejta e qasjes në gjykatë të jetë efektive, individi duhet të ketë gjithashtu një mundësi të qartë dhe reale për të kontestuar vendimin që shkel të drejtat e tij/saj. Më konkretisht, e drejta e qasjes në gjykatë nuk shterohet vetëm në të drejtën për të filluar procedurën në gjykatë, por kuptimi i saj është shumë më i gjerë, pasi që përfshin të drejtën për *"zgjidhjen*" e kontestit nga gjykata kompetente (shih rastet: KI62/17, parashtruese *Emine Simnica*, Aktgjykim i 29 majit 2018, paragrafi 55; KI224/19, parashtrues *Islam Krasniqi*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020, paragrafi 39; KI20/21, parashtrues *Violeta Todorović*, Aktgjykim i 13 prillit 2021, paragrafi 43).

60. Për më tepër, Gjykata thekson që respektimi i rregullave formale, përmes të cilave palët sigurojnë zgjidhjen e një kontesti, është me vlerë dhe e rëndësishme për shkak se: është në gjendje të kufizojë diskrecionin; të sigurojë barazi të palëve; të parandalojë arbitraritet; të sigurojë zgjidhje efektive të një kontesti dhe të gjykimit brenda një kohe të arsyeshme; dhe të garantojë siguri juridike dhe respekt për gjykatën. Megjithatë, sipas praktikës së mirë të konsoliduar gjyqësore të GJEDNJ-së, "*formalizmi i tepruar*" mund të bjerë ndesh me kriterin e garantimit të së drejtës praktike dhe efektive të qasjes në gjykatë në kuptim të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. Sipas GJEDNJ-së, kjo ndodh zakonisht në rastet e një interpretimi strikt apo të ngushtë të një rregulli procedural, duke rezultuar në pengimin e shqyrtimit të një parashtrese të parashtruesit që e njëjta të vlerësohet në merita, dhe me shfaqjen e rrezikut që e drejta e tij/ saj për mbrojtje efektive të gjykatës të cenohet (shih rastin *Běleš dhe të Tjerët kundër Republikës së Çekisë*, nr. 47273/99, Aktgjykim i 12 nëntorit 2022, paragrafët 50-51).

61. Për më tepër, Gjykata rikujton që GJEDNJ ka konstatuar se e drejta e qasjes në gjykatë vlen edhe për rastet penale (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 13 majit 2001, *Krombach kundër Francës*, nr. 29731/96, paragrafi 96; shih rastin e Gjykatës: KI62/17, parashtruese *Emine Simnica* Aktgjykim i 29 majit 2018, paragrafi 56).

62. Sa i përket të drejtës për mjet juridik dhe të drejtës për mbrojtje gjyqësore, Gjykata në praktikën e saj gjyqësore, e cila bazohet në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka theksuar se në parim dhe në tërësinë e tyre, neni 54 [Mbrojte Gjyqësore e të Drejtave] i Kushtetutës për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave, neni 32 i Kushtetutës për të drejtën në mjet juridik dhe neni 13 i KEDNJ-së për të drejtën për zgjidhje efektive, garantojnë: (i) të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose të mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose me ligj; (ii) të drejtën për të përdorur mjet juridik kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat e garantuara në mënyrën e përcaktuar me ligj; (iii) të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë është shkelur; dhe (iv) të drejtën për një zgjidhje efektive në nivel kombëtar nëse është shkelur një e drejtë e garantuar me KEDNJ-në (shih rastet e Gjykatës: KI48/18, parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës,* Aktgjykim i 23 janarit 2019, paragrafi 198; dhe KI272/23, parashtrues *Ali Tahiri,* Aktgjykim i 16 korrik 2024, paragraf 32; KI180/25, parashtrues *Engjellush Ibrahimi*, Aktgjykim i 5 nëntorit 2025, paragrafi 40; dhe rastin e GJEDNJ-së, *Boyle dhe Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 27 prillit 1998, paragrafi 52). Në këtë aspekt, Gjykata, duke iu referuar qëndrimit të GJEDNJ-së, vëren se kjo e fundit ka vënë në pah se neni 13 duhet të jetë *"efektiv"* si në praktikë ashtu edhe me ligj (shih rastet e GJEDNJ-së: *Ilhan kundër Turqisë*, Aktgjykimi i 27 qershorit 2000).

63. Më konkretisht, në kuptim të së drejtës për mjet juridik, Gjykata, duke afirmuar edhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, rikujton se efikasiteti i mjeteve juridike të parapara me nenin 32 të Kushtetutës nuk përcaktohet në bazë të asaj nëse parashtruesi i kërkesës me shfrytëzimin e tyre ka arritur t'i realizojë qëllimet e tij në mënyrën se si ai kishte synuar, por nëse ai kishte pasur mundësinë që me mjetin juridik që ai e shfrytëzon të mund të paraqesë argumentet e tij që do të shqyrtohen nga autoritetet kompetente (shih rastin e Gjykatës KI76/20, parashtrues *Kujtim Zarari*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 korrikut 2020, paragrafi 45, dhe rastin e GJEDNJ-së *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 14038/88, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 120).

(b) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

64. Gjykata, bazuar në shkresat e lëndës, rikujton se esenca e pretendimit për shkelje të së drejtës për të pasur "*qasje në gjykatë*" dhe "*të drejtës për mjet efektiv juridik*", ka të bëjë me mosshqyrtimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në merita nga ana e Gjykatës Supreme, pasi kjo e fundit kishte vlerësuar se, në rrethanat e rastit konkret, parashtruesit të kërkesës, i është aprovuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë sa i përket rishikimit të procedurës dhe se lënda është rikthyer në rigjykim.

65. Duke iu rikthyer rrethanave të rastit konkret, Gjykata vëren se përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 132/22] të 15 marsit 2023, Gjykata Themelore shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për shkak të kryerjes së veprës penale të dhunimit nga neni 193, paragrafi 3 pika 5 lidhur me paragrafin 4 dhe nenin 23 të KPK-së, dhe e gjykoi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) vite e gjashtë (6) muaj, ku në dënimin e shqiptuar i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 29 shkurtit 2012 deri më 6 nëntor 2012, ndërsa me Aktgjykimin [PAKR. nr. 225/23] të 10 majit 2023 të Gjykatës së Apelit u ndryshua aktgjykimi i Gjykatës Themelore përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale dhe vendimit mbi dënimin ashtu që parashtruesit të kërkesës i uli dënimin, duke i shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vitesh. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar rishikim të procedurës, të cilën kërkesë e kishte refuzuar Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PK. nr. 110/2023], dhe po ashtu e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN. nr. 1001/2023].

66. Tutje, Gjykata vëren se përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës ka parashtruar dy kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, përkatësisht (i) kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit [PN. nr. 1001/2023] të 29 gushtit 2023 që lidhet me kërkesën e tij për rishikim të procedurës penale të vendosur përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 225/23] të 10 majit 2023 të Gjykatës së Apelit, dhe (ii) kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 132/2022] i 15 marsit 2023 të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit [PAKR. nr. 225/23] të 10 majit 2023 të Gjykatës së Apelit.

67. Më 29 nëntor 2023, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 504/2023] e kishte aprovuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës dhe anuloi Aktvendimin [PK. nr. 110/2023] e Gjykatës Themelore të 19 korrikut 2023 dhe Aktgjykimin [PN. nr. 1001/2023] të 29 gushtit 2023, dhe kishte rikthyer çështjen në rivendosje në Gjykatën e Apelit për rishikim të procedurës penale si gjykatë kompetente.

68. Po në të njëjtën ditë, Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit [Pml. nr. 477/2023] e kishte hedhur poshtë si jolëndore kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 132/2022] të 15 marsit 2023, të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit [PAKR. nr. 225/23] të 10 majit 2023 të Gjykatës së Apelit, me arsyetimin se "*Meqenëse kjo gjykatë, me Aktgjykimin Pml. nr. 504/2023 të 29 nëntorit 2023, ka aprovuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të paraqitur kundër vendimeve të instancave*

më të ulëta lidhur me kërkesën për rishikim të procedurës penale dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje në Gjykatën e Apelit të Kosovës, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se tani për tani kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është jolëndore, sepse tani më nuk ka objekt të shqyrtimit".

69. Duke aplikuar parimet për të drejtën e qasjes në gjykatë, Gjykata rikujton se kjo e drejtë duhet të jetë praktike dhe efektive, dhe jo thjesht teorike. Qasja në gjykatë nuk shterohet me mundësinë formale për të paraqitur një mjet juridik, por kërkon që pretendimet e palës të shqyrtohen realisht dhe në merita nga një gjykatë kompetente.

70. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës kishte shfrytëzuar mjetet juridike të parapara me ligj, duke paraqitur dy kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë: (i) njëra lidhur me vendimet për rishikimin e procedurës penale dhe (ii) tjetra drejtpërdrejt kundër aktgjykimeve dënuese. Edhe pse këto kërkesa kishin ndërlidhje faktike dhe procedurale, ato kishin objekt të dallueshëm juridik dhe synonin kontroll të veçantë të ligjshmërisë së vendimeve përkatëse. Sidoqoftë, ai nuk mori përgjigje mbi pretendimet e tij ankimore nga Gjykata Supreme lidhur me kërkesën e tij kundër aktgjykimeve dënuese të Gjykatës Themelore dhe të Apelit, dhe se vendimet e tyre mbeten të pashqyrtuara në aspektin ligjor dhe kushtetues.

71. Gjykata vëren se, Gjykata Supreme, pasi aprovoi kërkesën që kishte të bënte me rishikimin e procedurës dhe e ktheu çështjen në rivendosje, kërkesën tjetër e hodhi poshtë si "*jolëndore*", me arsyetimin se tashmë nuk kishte objekt shqyrtimi. Megjithatë, në momentin e marrjes së këtij vendimi, aktgjykimet dënuese vazhdonin të prodhonin pasoja juridike dhe nuk ishin shfuqizuar. Për rrjedhojë, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kundër tyre nuk mund të konsiderohej pa objekt shqyrtimi.

72. Gjykata thekson se, Gjykata Supreme, përkundër faktit që e ka aprovuar kërkesën e parë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe ka kthyer çështjen në rivendosje, është dashur të merret edhe me kërkesën e dytë dhe ta shqyrtojë atë në merita. Kjo për arsye se kërkesa e dytë nuk kishte të njëjtin objekt me të parën, por synonte vlerësimin e ligjshmërisë së vetë aktgjykimeve penale të formës së prerë. Si e tillë, ajo përbënte një mjet juridik të pavarur dhe substancial, i cili ngrinte pretendime që nuk shteroheshin apo bëheshin të panevojshme vetëm për shkak të kthimit të çështjes në rivendosje në kuadër të procedurës së rishikimit.

73. Gjykata vëren se refuzimi i kësaj kërkese si "*jolëndore*" me arsyetimin se nuk ekziston më objekt shqyrtimi nuk është bindës, sepse aktgjykimet e kontestuara vazhdonin të ekzistonin juridikisht dhe të prodhonin pasoja deri në nxjerrjen e një vendimi të ri. Për më tepër, shqyrtimi në merita i kërkesës së dytë do të kontribuonte në sigurinë juridike dhe në evitimin e zvarritjeve të panevojshme procedurale, duke mundësuar që çështjet e ngritura lidhur me ligjshmërinë e aktgjykimeve të trajtohen në mënyrë përfundimtare pa pritur një proces të ri gjyqësor. Në këtë kuptim, mosshqyrtimi i saj cenon parimin e qasjes në gjykatë dhe të drejtën për një mjet juridik efektiv.

74. Prandaj, Gjykata vlerëson se, duke mos e shqyrtuar këtë kërkesë në merita, Gjykata Supreme aplikoi një qasje formale, e cila i mohoi parashtruesit të kërkesës mundësinë reale që pretendimet e tij për shkelje të ligjit të vlerësoheshin. Një interpretim i tillë procedural përbën formalizëm të tepruar dhe cenon thelbin e së drejtës për qasje në gjykatë, pasi kufizimi i aplikuar nuk rezulton të ketë qenë proporcional me qëllimin e synuar. Në këto rrethana, ndonëse parashtruesi formalisht kishte në dispozicion një mjet juridik, ai nuk përfitoi nga një shqyrtim efektiv i pretendimeve të tij.

75. Si pasojë, hedhja poshtë e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës si të palejuar nga ana e Gjykatës Supreme, ka cenuar (i) të drejtën për "*qasje në gjykatë*"

si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së; si dhe (ii) "*të drejtën për mjete juridike*" të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës.

76. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se ky përfundim ekskluzivisht ka të bëjë me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme sa i përket shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

77. Në fund, Gjykata, duke pasur parasysh të lartcekurat, konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohen ndaras pretendimet e parashtruesit të kërkesës sa i përket tejzgjatjes së procedurës dhe pretendimet të tjera të tij ndërlidhur me nenet e tjera të Kushtetutës dhe KEDNJ-së.

Kërkesa për moszbulimin të identitetit

78. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar moszbulim të identitetit të palëve në procedurë, ku lidhur me kërkesën për moszbulim të identitetit arsyeton si në vijim: "*... I lutem gjykatës që të mos zbuloj identitetin e palëve duke pasur parasysh se është procedurë për të mitur, dhe se me vendim të gjykatave procedura ka qenë e mbyllur nga publiku*".

79. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet rregullit 24 (1) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Kurdo përgjatë procedurës së shqyrtimit të një kërkese individuale sipas paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe deri në publikimin e vendimit përfundimtar, palët mund të kërkojnë që identiteti i tyre të mos zbulohet publikisht. Kërkesa duhet të jetë e arsyetuar".*

80. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 8 (1) të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, që përcakton:

> *"Shtetet palë marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, sipas ligjit, pa ndërhyrje të paligjshme".*

81. Gjykata vëren se në këtë rast parashtruesi i kërkesës akuzohet për veprën penale të dhunimit dhe se pala e dëmtuar në rast ishte e mitur, dhe me këtë Gjykata konsideron se në një rast të tillë ku kemi të bëjmë me veprën penale të dhunimit, publiciteti mund, madje edhe në mënyrë të tërthortë, të ndikojë në identitetin, emrin dhe marrëdhëniet familjare të viktimës së mitur.

82. Prandaj, në pajtim me nenin 8. 1 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe rregullin 24 (1) të Rregullores së punës, Gjykata miraton kërkesën e parashtruesit për moszbulimin e identitetit të tij dhe të palëve në procedurë publikisht.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 24 (1) dhe 34 (1) (b) të Rregullores së punës, më 2 prill 2026:

VENDOS

I. TË DEKLAROJË me gjashtë (6) vota "*për*" dhe një (1) votë "*kundër*", kërkesën të pranueshme;

II. TË APROVOJË me gjashtë (6) vota "*për*" dhe një (1) votë "*kundër*", kërkesën për moszbulim të identitetit;

III. TË KONSTATOJË me gjashtë (6) vota "*për*" dhe një (1) votë "*kundër*", se Aktvendimi [Pml. nr. 477/2023] i 29 nëntorit 2023 i Gjykatës Supreme të Kosovës nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;

IV. TË SHPALLË me gjashtë (6) vota "*për*" dhe një (1) votë "*kundër*", të pavlefshëm Aktvendimin [Pml. nr. 477/2023] e 29 nëntorit 2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës;

V. TË KTHEJË Aktvendimin [Pml. nr. 477/2023] e 29 nëntorit 2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës në rivendosje, sipas konstatimeve të këtij aktgjykimi;

VI. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

VII. TË KONSTATOJË që ky aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Remzije Istrefi-Peci Nexhmi Rexhepi